



KËSHILLI DREJTUES

VENDIM QARKULLUES

Nr. 32, datë 30.10.2020

**Mbi një ndryshim në Vendimin qarkullues të Këshillit Drejtues nr. 14, datë 30.4.2020 “Për caktimin e shoqërisë “PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k.” si auditues i brendshëm i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin financiar 2020”**

Në mbështetje dhe në zbatim të nenit 52, pika 1, shkronja “j”, të nenit 63, pika 2 të ligjit “Për Sigurimin e Depozitave” i ndryshuar; të nenit 7 pika 6 të Statutit të Agjencisë të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31.10.2018, të nenit 21, pika 21.2 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës nr. 61/15 prot, datë 30.04.2020 me objekt “Shërbim auditimi i brendshëm i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin financiar 2020”, të nenit 10, pika 6 të Rregullores të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, me propozim të PricewaterhouseCoopers Consulting sh.p.k., Këshilli Drejtues,

**V E N D O S I:**

1. Në Vendimin qarkullues të Këshillit Drejtues nr. 14, datë 30.4.2020 “Për caktimin e shoqërisë “PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k.” si auditues i brendshëm i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin financiar 2020” bëhet ndryshimi i mëposhtëm:  
*“a) Kudo në tekstin e vendimit emri i subjektit “PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k.” të ndryshojë në “PricewaterhouseCoopers Consulting sh.p.k.”.”*
2. Të autorizojë Drejtorin e Përgjithshëm për përfshirjen e këtij ndryshimi në kontratën e nënshkruar me palëve, nr. 61/15 prot., datë 30.4.2020 me objekt “Shërbim auditimi i brendshëm i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin financiar 2020”.
3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Martin Blushi

**Sekretar**

Donald Duraj

**Kryetar**